

URDHËR
Nr. 254, datë 26.7.2012

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), si dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 21.5.2003 “Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjyqimit.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, të këtij urdhri.

4. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 322, datë 9.8.2011 “Për delegim kompetence”, do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

5. Për autorizimet e lëshuara sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të gjejë zbatim ky i fundit.

6. Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër, revokohet.

7. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria Juridike, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka